

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)



Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

KËTË JAVË:

Raporti i Qeverisë për vitin 2008
Fragment nga 'Debati i përkryer',
shkruar nga Shqiptar Oseku

Raporti i Qeverisë për vitin 2008

Këtë javë Qeveria publikoi një raport, ku kishte bërë vlerësimin e të arriturave të veta për vitin 2008, duke i mbyllur sytë përballë krizës në të cilën ndodhet Kosova pothuajse një vit pas shpalljes së pavarësisë. Shtruarja e rrugëve me asfalt dhe ndërtimi i shkollave janë zhvillime pozitive, por ato e humbin çdo kuptim në një kontekst politik e ekonomik të formuar në mungesë të sovranitetit dhe pavarësisë.

'Shteti i ri i pavarur i Kosovës, që nuk është njohur nga dy të tretat e shteteve të botës – përfshirë këtu edhe pesë shtete anëtare të BE-së, mezi funksionon pas dhjetë vitesh të pushtetit të OKB-së. Ai ka nivel të lartë të papunësisë dhe pak investime të huaja, dhe ka nevojë për ndihmë shumë të madhe nga jashtë. Ajo çka e dëmton më së shumti politikisht shtetin e ri është pjesa veriore e Kosovës, kryesisht e banuar me serbë, e cila vazhdon të drejtohet nga Beogradi pa kundërshtime energjike nga BE-ja dhe SHBA-të. Kjo praktikisht e ndanë shtetin e brishtë të Kosovës dhe i përforcon tensionet e vazhdueshme etnike. Shkaku rrënjësor për pjesën më të madhe të këtij jostabiliteti qëndron tek Beogradi. Edhe pse qeveria e re atje mezi pret të bëhet pjesë e BE-së, ajo këmbëngul në qeverisjen e serbëve në Kosovë dhe po bën çdo gjë që është e mundur ta zbrapsë pavarësinë e saj'.
Morton Abramowitz & Daniel Serwer,
Wall Street Journal, 5 janar, 2009

Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi nuk kanë qenë të pafuqishëm në parandalimin e kësaj krize të sovranitetit dhe tërësisë sonë territoriale. Ata e aprovuan një Deklaratë të Pavarësisë, e cila thotë se Kosova do të veprojë në përputhshmëri me Rezolutën 1244, edhe pse kjo rezolutë e njëh tërësinë territoriale dhe sovranitetin e ish Jugosllavisë, tash Serbisë, mbi Kosovën. Deklarata po ashtu i përfshiu obligimet ndaj Planit Ahtisari, edhe pse Serbia nuk do ta njihje Kosovën. Në fund, ajo e ftoi dhe i dëshiroi

mirëseardhje 'një pranie ndërkombëtare' (tash UNMIK dhe EULEX), që të veprojë në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244, Zyren Ndërkombëtare Civile (ICO) që ta mbikqyrë zbatimin e Planit Ahtisari dhe një mision të BE-së për zbatimin e ligjit (EULEX). Ajo nuk i ftoi këto misione si palë të barabarta për monitorim, por iu dha atyre fuqi ekzekutive.

Përmbajtja e kësaj Deklarate i theksoi elementet pozitive të njohjes nga jashtë. Ajo e bëri të mundur që Kosova t'i nënshtrohet pushtetit ekzekutiv të EULEX-it, i cili nuk e njeh pavarësinë e Kosovës; t'i nënshtrohet ICO-së, e cila po e mbikqyr zbatimin e Planit Ahtisari që e ndanë Kosovën territorialisht dhe etnikisht; dhe në fund, e mundësoi rolin e vazhdueshëm të UNMIK-ut në ndërmjetësimin për detajet e Gjashtë Pikave, të cilat tashmë e ndajnë Kosovën institucionalisht dhe etnikisht.

Kushtetuta, e cila rrenjtë i ka në këtë Deklaratë, dhe e cila do të duhej të ishte dokumenti më i lartë ligjor në vend, u bazua në Planin Ahtisari dhe ligjet e saj zunë vend dytësor pas këtij plani. Gjithashtu, Qeveria dhe Kuvendi, në vend se ta përftojë pushtetin e tyre prej popullit dhe t'i japin llogari popullit, u vunë në pozitë ku duhet t'i japin llogari Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICR) dhe EULEX-it, dhe të varen prej tyre për pushtet. Kapaciteti i Serbisë për ta zgjeruar kontrollin e vet brenda Kosovës u rrit, derisa kapaciteti i institucioneve të Kosovës për ta parandaluar këtë zgjerim u kufizua atëherë kur ata ia nënështroan veten e tyre misioneve ndërkombëtare, të cilat udhëhiqen nga interesat e veta, e jo nga ato të Kosovës.

Ndonëse ia ka lidhur vetes duart brenda kësaj strukture të varësisë, qeveria ka pasur raste për të vepruar. Por nuk e ka bërë një gjë të tillë. Ajo nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash për ta shtrirë më gjerë pushtetin e institucioneve të Kosovës në veriun e Kosovës, përkundër konfuzionit që rezultoi nga ballafaqimet rreth misionit të EULEX-it mes OKB-së dhe BE-së gjatë pjesës më të madhe të vitit 2008. Ajo është pajtuar me retorikën

Nr.129, 12 janar 2009

ndërkombëtare që e thekson 'tolerancën' si të vetmen zgjidhje për veriun. Kjo retorikë supozon se dhuna është rezultat i tensioneve ndëretnike, e jo rezultat i drejtpërdrejtë i politikave të Serbisë në Kosovë. Si pasojë e kësaj, Qeveria nuk i ka shtyer BE-në dhe SHBA-të që ta dënojnë Serbinë për sjelljet e saj në Kosovë. Në fund, për shkak se politikanët tanë pranuan të bëjnë kompromis rreth sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës në fillim të negociatave, ata janë të gatshëm të pranojnë edhe kompromise të tjera. Ata nuk e kanë hedhur poshtë Planin Ahtisari edhe pse Serbia nuk e ka njohur Kosovën. Në fund, Qeveria po qëndron anash derisa Gjashtë Pikat po zbatohen brenda Kosovës. Qeveria e Kosovës është bërë spektatore para ndarjes etnike, institucionale dhe territoriale të Kosovës.

Fragment nga 'Debati i përkryer',
shkruar nga Shqiptar Oseku

Duke folur kundër obsesionit të Qeverisë me njohjen e Kosovës, Shqiptar Oseku shkroi në gazetën tonë, "Po të isha më afër tyre, unë do t'i këshilloja të ndalen e të konsultohen një herë me homologët e shtetit palestinez, që u shpall më 1988, është njohur nga dhjetëra shtete, është vëzhgues zyrtar në OKB, anëtar fuqiplotë në Lidhjen Arabe, e merr pjesë në Lojërat Olimpikë. Apo me Republikën demokratike Arabe të Saharasë, që është njohur *en block* nga Unioni Afrikan, ka marrëdhënie diplomatike me 80 vende tjera, e 13 ambasada jashtë vendit. Për të kuptuar qartë sa vlenë njohja ndërkombëtare, kur ta kesh pleh realitetin në terren. E pastaj, kur të kenë mbaruar punë aty, të shkojnë edhe në Tajvanin e vogël, që njihet sall nga 23 shtete të papërfillshme, por që i shet teknologji raketore SHBA-ve. Do t'i këshilloja që ta ndalin përnjëherë valsin e kotë të njohjeve, e t'i përvjeljin mangët për të pastruar tre E-të që përbëjnë plehun në terren. Enklavat, EULEX-in, ekonominë. Sovraniteti - ai territorial, politik, e ekonomik - është rruga e shpëtimit, e jo numri i vendeve që na kanë njohur."